



Përleshje mes disa personave në Podujevë- një i plagosur dhe një i lënduar me sëpatë



03/08/2025 08:39



Tre persona janë arrestuar në Dumnicë të Poshtme të Podujevës pasi dyshohet se janë rrahur mes vete dhe ka pasur të shtëna me armë zjarri.

Njëri prej tyre është lënduar nga sëpata, ndërsa tjetri është plagosur me armë.

Ata janë dërguar në QKUK, ndërsa i dyshuari që ka shtënë me armë është larguar.

“VRASJE NË TENTATIVË, ARMËMBAJTJE PA LEJE & Pjesëmarrje në rrahje- Dumnicë e Poshtme, Podujevë / 02.08.2025-20:44. Janë arrestuar tre të dyshuar kosovarë pasi të njëjtit për motive të panjohura janë përfshirë në rrahje në mes veti, dhe dyshohet se gjatë përleshjes ka pasë edhe të shtëna me armë zjarri. Si pasojë, njëri nga të dyshuarit ka pësuar lëndime nga një mjet i fortë-sëpatë, ndërsa i dyshuari tjetër është plagosur me armë zjarri. Të lënduarit janë dërguar për tretman mjekësor në QKUK, ndërsa i dyshuari që ka shtënë me armë zjarri është arratisur nga vendi i ngjarjes. Në vendin e ngjarjes janë gjetur dhe konfiskuar: dy vetura-njëra e dëmtuar, një sëpatë, dy sprej një shkop metalí dhe tre zinxhirë dore. Lidhur me rastin është informuar e konsultuar edhe prokurori, ndërsa njësitet policore janë duke hetuar rastin.”

LAJME TË FUNDIT



Vetmia tek adoleshentët: Një shqetësim global që ndihet edhe në Kosovë



Dodik thotë se Republika Sërpska do të hakmerret...




Deri në 40 minuta pritje te Dheu i Bardhë për të hyrë në Kosovë



Fermerët ankohen për vonesën në subvencione, Ministria e...

Artikuj të ngjashëm



August 3, 2025

Vetmia tek adoleshentët: Një shqetësim global që ndihet edhe në Kosovë



August 3, 2025

Dodik thotë se Republika Sërpska do të hakmerret pas dënimit të...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
B.r. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr.

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information